



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARTA GJ. PJETËRNIKAJ
ADRESA NR.9, DERVISH HATIXHE,
NR.64, NR.1, NR.1
TEL: 0672029096

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1241

Nr. koleksioni: 760

Tirane më 26/04/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2023052690083884260



A2023052690083884260

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË “HOME STYLE Distribution” SH.P.K)

Sot, më datë 26/04/2023, para meje Notere ARTA GJ. PJETËRNIKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, DERVISH HATIXHE, NR.64, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

SHITES: Ardit Balilaj, atësia Pëllumb, amësia Elisaveta, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Kongresi I Lushnjes; Nd. 5; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 17/11/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033505480 dhe nr. personal I81117051L, .

DHENESE PELQIMI: Sonila Balilaj, atësia Shukri, amësia Xhevahire, shtetase Shqiptare, lindur në Kukës dhe banuese në TIRANË, me adresë Kongresi I Lushnjes; Nd. 5; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 09/09/1988, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038075270 dhe nr. personal I85909072C, .

BLERES: Armando Gjini, atësia Bilal, amësia Mihane, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Don Bosko; Nd. 50; H. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 06/11/1984, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034463843 dhe nr. personal I41106058I, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “HOME STYLE Distribution” sh.p.k. sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1– KUSHTE TË PËRGJITHSHME

1.1 Pala shitese, **Ardit BALILAJ**, është ortak ne shoqerine “HOME STYLE Distribution” shpk, person juridik shqiptar, e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, në Qendren Kombetare te Biznesit, me nr. NUIS L92211020H, dhe zotëron 48% te kuotave te kapitalit te shoqërisë me vlerë 20.000 (njetete mije) Leke, të cilat korrespondojnë 1 (nje) kuote (pjese) me vlere 9.600(nentemije e gjashteqind) Leke.

Ky fakt vërtetohet dhe nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar te lëshuar nga QKB, për Shoqërinë “HOME STYLE Distribution” shpk, që i bashkelidhet kësaj kontrate.

1.2 Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “HOME STYLE Distribution” shpk nder te tjera është vendosur:

➤ Kapitali i shoqërisë “HOME STYLE Distribution” shpk me vlerë 20.000 (njetete mije) Leke, zotërohet në masën 100% (njëqind për qind) te kuotave te kapitalit te shoqërisë nga ortakët; Z. Armando Gjini, të cilit i korrespondon 1 (nje) kuote (pjese) me pjesëmarje 52% në kapital; si dhe ortakë Ardit Balilaj, të cilit korrespondon 1 (nje) kuote (pjese) me pjesëmarje 48% në kpitale.



A2023052690083884260

➤ Shitjen e kuotave te kapitalit te shoqerise “**HOME STYLE Distribution**” shpk në masën 48% te kuotave te kapitalit te shoqërisë me vlerë 9.600 (*nentemije e gjashteqind*) Leke, qe zoterohen nga ortaku **Ardit Balilaj**.

➤ Duke qenë se Z. Armando GJINI është ortak i Shoqerise “**HOME STYLE Distribution**” shpk shitja e pjesës së kapitalit që zotërohet nga ortaku Ardit BALILAJ, nuk i nënshtrohet të drejtës së parablerjes, pasi shoqëria nuk ka ortak tjetër që të ushtroj të drejtën e blerjes së kësaj kuote.

➤ Miratohet shitja në masën 48% te kuotave te kapitalit te shoqërisë “**HOME STYLE Distribution**” shpk me çmim shitje ne vleren montare prej 9.600(*nentemije e gjashteqind*) Leke, me palë blerëse Z. Armando GJINI, shume te cilen e ka likujduar totalisht para nenshkrimit te kesaj kontrate.

1.3. Z. Armando GJINI, me nënshkrimin e kësaj kontrate, do te jetë ortak i vetem i Shoqërisë “**HOME STYLE Distribution**” shpk duke zotëruar **100% (njëqind për qind) te kuotave të kapitalit të shoqërisë “HOME STYLE Distribution” shpk me vlerë 20.000(njezete mije) Leke, të cilat korrespondojnë 1 (nje) kuote (pjesë), me vlere 20.000 (njezet mije) Leke.**

NENI 2- OBJEKTI I KONTRATËS DHE ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE TE KAPITALIT

Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë nëpërmjet shitjes të **48% (dyzete e tete perqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “HOME STYLE Distribution” shpk**, te cilat zoterohen nga ortaku **Ardit Balilaj**, ne vleren nominale prej 9.600 (*nentemije e gjashteqind*) Leke, **tek ortaku Armando GJINI**, sipas kriterëve te përcaktuara ne këtë kontrate. PAGESA E ÇMIMIT TE KËTYRE KUOTAVE ESHTË NE VLERËN TOTALE PREJ 9.600 (nente mije e gjashteqind) Leke, sipas deklarimeve te palëve eshte likujduar totalisht jashte kësaj zyre.

NENI 3 – BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kesaj kontrate shitje kuotash kapitali:

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij, Nenet 761 e vijues ;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.
- 3.4. Rregullimet e bera statutin të shoqërisë “**HOME STYLE Distribution**” shpk dhe në aktin e themelimit te saj.

NENI 4- TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1 Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesi **Ardit Balilaj** zhvishet nga pronesia e 48% (*dyzete e tete perqind*) te kapitalit themeltar qe zoteron ne shoqërinë “**HOME STYLE Distribution**” shpk, kundrejt vlerës se shitjes prej 9.600 (*nentemije e gjashteqind*) Leke, dhe blerësi **Z. Armando GJINI**, ortak i shoqërisë i cili edhe zoteron 52% te kapitalit te shoqerise “**HOME STYLE Distribution**” shpk, pasi e ka nenshkuar plotesisht kete kapital, fiton të drejtat e plotë për 48% tjetër të kapitalit të shoqërisë.

4.2 Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash, shoqëria “**HOME STYLE Distribution**” shpk behet shoqeri me një ortak te vetem, kapitali i se ciles eshte nenshkuar plotesisht dhe zoterohet si me poshte:



A2023052690083884260

a) **Armando GJINI**, zotërues i 1 (nje) kuote (pjesë) me pjesëmarrje në përqindje 100% (njëqind përqind) të kuotave, të cilat korrespondojnë me vlerë 20.000 (njëzetë mijë) Leke.

4.3 Palet nënshkruese të këtij akti noterial bien dakord që në respektim të legjislacionit shqiptar në fuqi të marrin pjesë për të gjitha detyrimet që i lindin nga emerimi i tyre si Administratore të Shoqërisë "HOME STYLE Distribution" shpk, në periudhën në të cilën ata e kanë ushtruar detyrën e Administratorit, duke mos patur asnjë pretendim as sot dhe as në të ardhmen në lidhje me këto detyrime.

4.4. Palet deklarojnë se mbajnë përgjegjësi ligjore dhe personale për çdo veprim të kryer prej tyre në mënyrë të pavarur gjatë kohës së administrimit të shoqërisë dhe pasojat juridike dhe financiare që lindin prej tyre.

4.5. Pala shitesë e kuotave të kapitalit të shoqërisë, me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar deklaron me përgjegjësi ligjore dhe personale se nuk ka asnjë lloj pretendimi sot dhe as nuk do të ketë në të ardhmen në lidhje me shpërndarjen e dividendit të shoqërisë, si dhe çdo lloj përfitimi tjetër që i takonte si ortak i shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 5- TË NDRYSHME

5.1 Kësaj kontrate i bashkelidhen dhe janë pjesë përbërëse e saj dokumentacioni si më poshtë vijon:

- i. Kopje e ekstraktit të regjistrit tregtar të nxjerrë online nga QKB;
- ii. Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë "HOME STYLE Distribution" shpk;
- iii. Kopje e dokumentacionit identifikues të palëve.
- iv. Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë për ortakët dhe Shoqërinë "HOME STYLE Distribution" shpk.
- v. Certifikatë familjare e palës Shitëse.

Per sa me sipër, kontrata u lexua me ze të lartë dhe të qartë nga unë Noteri në gjuhën shqipe dhe pasi u gjend e rregullt, e hartuar sipas vullnetit të lirë të palëve, nënshkruhet prej tyre në praninë time. Kontrata për sa më sipër, redaktohet në katër kopje të barasvleshme nga të cilat një depozitohet në arkivën e noteres, një kopje e merr pala shitesë dhe dy kopje i merr pala blerëse.

Duke qenë e bindur për identitetin e palëve dhe vullnetin e tyre të lirë unë Noterja e legalizoj aktin e mësipërm në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 62/II të ligjit 110/2018 "Për Noterine", me ligjin nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterine".

Unë noterja, në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar), deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti noterial/vertetimi noterial në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET KONTRAKTUESE

SHITËSI

Ardit BALILAJ

Ardit Balilaj

DHENESE PELQIMI

Sonila BALILAJ

Sonila Balilaj

S300

BLERËSI

Armando GJINI

Armando Gjini

NOTERE

ARTA GJ. PJETËRNIKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA “HOME STYLE Distribution” Shpk

Tirane, Njesia Bashkiake nr. 8, Tregu Uzina Dinamo, Seksioni D, Magazina nr. 18.

NIPT: L92211020H

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKEVE

Në Tirane sot, më datë, 25/04/2023, ne selinë e shoqërisë, u mbledh Asambleja e Ortakeve te Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar HOME STYLE Distribution e regjistruar ne QKB me numer NIPT-i L92211020H, e përbërë nga ortaket:

- **Z.Ardit BALILAJ**, i biri i Pellumb, i datelindjes 17.11.1988, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. 033505480 dhe nr. I81117051L personal, me date leshimi 10.10.2017;
- **Z. Armando GJINI**, i biri i Bilal, i datelindjes 06.11.1984, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. 034463843 dhe nr. I41106058I personal, me date leshimi 12.07.2019;

Mbledhjen e kryesoi Administratori i Shoqerise **Z. Armando GJINI**, i biri i Bilal, i datelindjes 06.11.1984, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. 034463843 dhe nr. I41106058I personal, me date leshimi 12.07.2019, i cili konstatoi se mbledhja është e vlefshme, pasi asambleja është thirrur konform statutit të shoqërisë dhe se janë prezent përfaqësuesit e te gjitha kuotave si me poshtë:

- **Armando GJINI**, zotërues i 52 (*pesedhjete e dy*) % te kapitalit në shoqërinë e, te cilit i korrespondon 1 (*nje*) pjese, me vlere nominale 10.400 (*dhjete mije e katerqind*) Leke .
- **Ardit BALILAJ**, zotërues i 48 (*dyzete e tete*) % te kapitalit te shoqerisë se mësipërme te cilit i korrespondon 1 (*nje*) pjese me vlere nominale 9.600 (*nentemije e gjashteqind*) Leke.

Administratori e deklaroi mbledhjen te hapur me këtë **REND DITE** :

- Miratimin e transferimit të 48 % të koutave te kapitalit te shoqerise “**HOME STYLE Distribution**” shpk qe i perkasin ortakut Ardit Balilaj tek ortaku Armando GJINI në përputhje me dispozita e Kodit Civil, nenit 73/ç dhe 81 nëpërmjet aktit noterial “Kontratë Shitje”.

DUKE QENE SE:

Shoqëria “**HOME STYLE Distribution**” shpk është person juridik shqiptar, i themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, pranë QKB me date 11.10.2019. Kapitali i shoqerise eshte 20.000 (*njezete mije*) Leke, i ndare ne 1(*nje*)pjese me vlere 20.000 (*njezete mije*) Leke , kapital i cili eshte nënshkruar plotësisht dhe perbehet nga :

- 1 (nje) pjese te ortakut **Armando GJINI**, zoterues i 52 % te kuotave, me vlere totale 10.400 leke;
- 1 (nje) pjese te ortakut **Ardit BALILAJ**, zoterues i 48 % te kuotave, me vlere totale 9.600 leke;

Asambleja e ortakeve te Shoqerise "**HOME STYLE Distribution**" shpk pasi mori ne shqyrtim veprimtarine e shoqerise, statutin dhe aktin e themelimit, kerkesen e ortakut Ardit BALILAJ per shitjen e :

- 48% te kuotave te saj qe zoterohen nga Ardit Balilaj tek ortaku Armando Gjini dhe pasi konstatoi kuorumin e saj, unanimisht:

V E N D O S I:

I- Shitjen e kuotave te kapitalit te shoqerise "**HOME STYLE Distribution**" shpk qe zoteroohen rregullisht ne masen 48 % te kuotave te kapitalit te shoqerise, te cilat i korrespondojne 1 (nje) pjese me vlere nominale 9.600 (nentemije e gjashteqind) Leke te disponuar nga ortaku Ardit BALILAJ **tek ortaku Armando GJINI, duke u bere Armando Gjini** zoterues i 100 (njqind) % te kuotave ne shoqerine e mesiperme me vlere 20.000 (njezete mije) Lekë, te cilat korrespondojne 1 (nje) pjese me vlere nominale 20.000 (njezete mije) Leke


II- Shoqeria "**HOME STYLE Distribution**" shpk duke filluar nga data e depozitimit te ketij vendimi ne Qendren Kombetare te Biznesit do te jete **shoqeri e ortakut te vetem i cili do te zoteroje ne kete shoqeri kuotat si me poshte:**

Armando Gjini, zoterues i 100 (njqind) % te kuotave ne shoqerine e mesiperme me vlere 20.000 (njezete mije) Lekë, te cilat korrespondojne 1 (nje) pjese me vlere nominale 20.000 (njezete mije) Leke.

III-Te pasqyrohen keto ndryshime ne Qendren Kombetare te Biznesit duke ngarkuar per regjistrimin e ketij vendimi personin si me poshte vijon:

- **Z. Armando GJINI**, i biri i Bilal, i datelindjes 06.11.1984, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. 034463843 dhe nr. I41106058I personal, me date leshimi 12.07.2019;

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE

1.Armando GJINI Armando Gjini 

2.Ardit BALILAJ Ardit Balilaj 